

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE

“TECH SATURN” shpk

Ne kete statut

- “Ligji” eshte Ligji Nr.9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise.

Kreu 1:

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- 1- Sot, me 18/09/2024 une themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin ”TECH SATURN” SHPK.
- 2- Themeluesit e shoqerise jane:
 - **Z.Tarzan Prenga**, shtetas shqiptar, me numer identifikimi J50817109R, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

Neni 2:

Objekti

2.1 Shoqeria do te kryej aktivitetin e vet konform Vendimit Nr.730, date 12.12.2018

“Per percaktimin e aktiviteteve qe perfshihen ne fushen e prodhimit/zhvillimit te software-ve, si me poshte vijon:

- Dizenjim software-i, ku perfshihet analiza e kerkesave te sisitemit software, projektimi i arkitektures dhe projektimi i detajuar i sistemit software.
- Zhvillim sistemesh migrimi, ku perfshihet transfermimi i te dhenave dhe infrastruktures perkatese nga nje teknologji e vjeter ne nje teknologji te re .
- Permiresi/upgrade sistemesh informatike.
- Operimi, menaxhimi, suportu i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software.
- Zhvillim dhe mirembajte sistemesh software, ku perfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, intergrimi i te gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit qe software-i eshte i vendosur ne operim), mirembajtja e te gjithë komponenteve, suportu i sistemit si nje teresi komponentesh,qe ne funksionimin e tyre, realizojne qellimin e zgjedhjes informatike.
- Testim software,ku perfshihet testimi i funksionaliteteve, te ngarkeses ne pune , te performances, te pranimit, te disponueshmerise dhe te sigurise se sistemit software.
- Dizenjimi dhe zhvillim sistemesh te komunikimit, ku perfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja ne pune dhe mirembajtja e sistemeve te komunikimit te

rrjeteve te pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN). Siguria kibernetike (cyber security).

- Dizenjimi dhe zhvillim sistemesh te sigurise, ku perfshihet analiza e kerkesave te sigurise se klientit, projektimi i arkitektures, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e sigurise dhe mirembajtja perkatese.

2.2 Shoqeria, me vendim te Asamblese se Pergjithshme, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera , si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

Neni 3:

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.

Neni 4:

Selia

Selia e shoqerise: Lagjja nr.17, Rruga“Stavri Th.Frashëri”, Njësia 6, Ndertesa nr.41, pasuria nr.12/271/ND, zona kadastrale nr.8513, Durres.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themetar i shoqerise “ TECH SATURN” perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme **50.000 (pesedhjete mije) leke**.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- **Z.Tarzan Prenga**, zoterues i **1 (nje)** kuote me vlere te pergjithshme **50.000 (pesedhjetemije)**

Leke qe perben **100%** te kapitalit themeltar te Shoqerise.

Shuma e kontributit ne para do te depozitohet ne Banke ne afatin dhe kushtet qe percaktohen per kete qellim me vendim te zakonshem te shoqerise.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga asambleja e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter e parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme nepermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- d) Emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “d” te kesaj pike.
- f) Ekzaminimin e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise te pergatitura nga administratoret.
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- i) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.
- j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve .
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- l) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Mbledhja e asamblese behet se paku nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare , raportin e administratoreve, ekspertin kontabel dhe inventarin.

Asambleja thirret permes njoftimit me leter, me lajmerim, marrje apo mesazh elektronik e cila duhet u dergohet ortakeve – ne adresen e treguar ne librin e ortakeve- se paku 15(pesembedhjete) dite para mbledhjes se Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacionin mbi llojin e takimit, per ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendimi, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

Asambleja do te mblidhet dhe zhvillohet rregullisht edhe ne mungese te pajtuesmerise me formalitetet e njoftimit, kur jane prezent ortaket qe perfaqesojne tere kapitalin e shoqerise. Ortaket gjithashtu mund te marrin pjese ne Asamblene e Pergjithshme nepermjet telekonferences ose perdorimit te mjeteve te tjera elektronike. Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:

- a) transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme me kohe reale
- b) komunikimin e ndersjelle ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendndodhje tjeter
- c) mekanizma qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaqesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zotrojne me shume se 30 perqind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare “, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te cituar, asambleja thirret perseri jo me vone se 30 dite me te njejten rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndaljen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- f) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12


Administrimi

Shoqeria administrohet nga 1 (nje) Administrator i cili emerohet per nje periudhe prej 5 (pese)vitesh deri ne momentin e revokimit ose doreheqjes nga ana e tij.

Administratori posedon te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem dhe te vecante te Shoqerise brenda kufijve te objektit te shoqerise, pervec atyre kompetencave qe ne baze te legjislacionit ose Statutit i takojne Asamblese.

Administrator i pare i shoqerise emerohet Z.Tarzan Prenga, shtetas Shqiptar me numer identifikimi J50817109R, madhor me zotesi te plote per te vepruar.

Nenshkrimi administratorit:

.....Tarzan Prenga.....

Administratori ka te gjitha kompetencat e percaktuara nga ligji dhe statuti i shoqerise.

Neni 13

Kompetencat e Administratoreve

Administratori ka te drejte e detyrohet te :

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.
- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare.
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.
- d) Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

- e) Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- f) Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raporton perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- h) Merr vendime per ndryshimin e adreses/ave te shoqerise, duke perfshire seline.
- i) Merr vendime per ndryshimin e objektit te aktivitetit.
- j) Kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 14

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17, 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
- b) Te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
- c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendimi.
- d) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise.
- e) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

Ortaket e shoqerise permes nje autorizimi te posacem, sipas dispozitave te nenit 36 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 ,”Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” apo nga asambleja e pergjithshme me tre te katertat e votave, sipas dispozitave te neneve 87 apo 145 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, mund te parashikojne lejimin e administratorit te shoqerise te mbaj nje pozicion drejtues, perfshire administrator apo te jete i punesuar ne shoqeri te tjera eksistuese apo te ardhshme, qe ushtrojne veprimtari ne te njejtin sektor spo sektor te ngjashem ekonomik me shoqerine.

Kreu IV

Viti Financiar

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht vitit i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Kreu V

Prishja-riorganizimi i shoqerise

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve
- b) Me hapjen e procedurave te falimentimit

Neni 17

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dizpozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 18

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dizpozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut , do te zbatohet dispozohet e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 19

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare e Rrethit Gjyqesor Durres.

Neni 20

Kopjet

Ky dokument redaktohet ne 5 (pese) kopje origjinale ne gjuhen shqipe. Lexuar, kuptuar, aprovuar e neshkruar nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES

Z.TARZAN PRENGA

